

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.

Nr.No.Br. 1/77

Dt. 30.11.2018

Fushë Kosovë - Fushë Kësova - Kosovo Polje

trainkos
HEKURUDHAT E KOSOVËS

2018

RAPORT NËNTËMUJOR

Janar - Shtator 2018



FUSHË KOSOVË,
Tetor 2018

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	6
III. 1.	Gjendja financiare Janar – Shtator 2018	6
III. 2.	Të hyrat	6
III. 3.	Shpenzimet	7
III. 4.	Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Shtator 2018	7
III. 5.	Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (30.09.2018)	9
III. 6.	Transaksionet e realizuara Janar – Shtator 2018	10
IV.	PASQYRA E PËRFORMANCËS OPERATIVE NË TRANSPORTIN E UDHËTARËVE	11
IV. 1.	Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve	11
IV. 2.	Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)	11
IV. 3.	Vonesa e trenave të udhëtarëve	12
V.	PASQYRA E PËRFORMANCËS OPERATIVE NË TRANSPORTIN E MALLRAVE	13
V. 1.	Shfrytëzimi i trenave	14
V. 2.	Neto Ton & Neto Ton kilometër të transportuar	14
V. 3.	Mallrat e transportuara	14
VI.	ZYRA E MIRËMBAJTJES E MJETEVE LËVIZËSE – MML	15
VI. 1.	Spektori i mirëmbajtjes	15
VII.	PROJEKTET KAPITALE	16
VIII.	KONTESTET GJYQËSORE	17
VIII. 1.	Kontestet për kompensim dëmi	17
VIII. 2.	Kontestet për pagim borxhi	18
VIII. 3.	Kontestet e marrëdhënies së punës	19
VIII. 4.	Kontestet gjatë vitit 2018	19
VIII. 5.	Lëndët përmbarimore	20
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT	21
IX. 1.	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit	21
IX. 2.	Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe institucionet tjera	23
IX. 3.	Aktivitetet e marketingut	24
IX. 4.	Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore	24
X.	SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – SHTATOR DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN	25

I. HYRJE

Raporti për periudhën Janar - Shtator për vitin 2018, për HK - Trainkos SH. A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të kompanisë duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet qartë aktivitetet gjatë këtij nëntëmujori në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu ky raport pasqyron vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të kompanisë për këtë nëntëmujor, sfida këto që përcillen nga vitet paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në mos arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë si rezultat i mungesës së kërkesës në treg, veçanërisht atyre të mallrave dhe në anën tjetër me një konkurrencë të egër nga operatorë të transportit rrugorë të mallrave.

Po ashtu, sfida në vete mbetet edhe (mos) realizimi i planifikimit të deklaruar nga klienti ynë kryesor “NewCo Feronikeli” në transportin e mallrave, i cili për një periudhë kohore kishte vështirësi në operim, ku të njëjtat shpresojmë të janë tejkaluar pas rifillimit të operimit nga shtatori (2018).

Vonesat në arritjen e marrëveshjes për Obligimet e Shërbimeve ndaj Publikut (OSHP) me Ministrinë e Infrastrukturës kanë krijuar vështirësi të theksuara edhe në këtë nëntëmujor. Megjithatë, është një e arritur e madhe në këtë drejtim pasi që marrëveshja tani është nënshkruar për një periudhë pesëvjeçare.


Përpjekjet tona në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për klientët tanë janë prioriteti ynë. Pas futjes në përdorim të dhjetë vagonëve për udhëtarë në fund vitin e kaluar, si dhe projektet e planifikuara për këtë vit, do të kenë ndikim në ofrimin e kushteve shumë më të mira për udhëtarë.

Gjithashtu është më e rëndësishme të theksohet se gjatë tremujorit të dytë (2018) është realizuar projekti për rinovimin e objektit administrativ i cili ka ndikuar dukshëm në krijimin e kushteve më të mira për stafin e ndërmarrjes.

Përkundër projekteve të theksuara më lart, të cilat janë realizuar me mjetet e ndara nga Aksionari për projektet kapitale, nevoja për investime ende vazhdon të mbetet sfida në vete pasi që pothuajse të gjitha mjetet tërheqëse/lëvizëse janë tejet të vjetruara përderisa investimet janë shumë të kufizuara për të bërë përtëritjen e tyre.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH. A.

Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh. A. brenda periudhës nëntë mujore (01.01.2018 - 30.09.2018), në strukturën Organizative ka pasur disa ndryshime.



Hekurudhat e Kosovës -Trainkos SH. A. brenda periudhës nëntë mujore janar – shtator 2018 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve. Në tabelën në vijim do të paraqesim gjendjen e të punësuarve në Kompani nga data 01.01.2018 deri më 30.09.2018, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata të afatizuara dhe të paafatizuara etj.

Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos - Sh. A. është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos-SH.A. më 01 Janar 2018 dhe më 30 Shtator 2018				
Totali i të punësuarve	01.01.2018		30.09.2018	
	233		229	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2018	30.09.2018	01.01.2018	30.09.2018
Mosha mesatare e punëtorëve	46.70	47.16	%	%
Me marrëdhënie të rregullt pune	233	229	%	%
Me kontratë të pa afatizuar	105	105	45.06 %	45.85 %
Me kontratë të afatizuar	128	124	54.93 %	54.14%
Meshkuj	208	204	89.27 %	89.08%
Femra	25	25	10.72 %	10.91%
Serbë	2	2	0.85 %	0.87 %
Shqiptarë	231	227	99.14 %	99.12 %
Me shkollim fillor	16	16	6.86 %	6.98 %
Me shkollim të mesëm	127	124	54.50 %	54.14 %
Kualifikim profesional	24	24	10.30 %	10.48 %
Me shkollim të lartë	4	4	1.71 %	1.74 %
Me shkollim superior	63	61	27.03 %	26.63 %
Departamenti i Operimeve	140	-	60.08%	
Departamenti i Transportit të Mallrave	-	47	-	20.52 %
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	-	63	-	27.51 %
Departamenti i Administratës	39	40	16.73%	17.46 %
Departamenti i Financave	10	10	4.29%	4.36 %
Departamenti i Zhvillimit	7	7	3.0%	3.05 %
Departamenti i Prokurimit	4	4	1.71	1.74%
Kabineti i KE-së	5	5	2.14%	2.18 %
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	20	19	8.58%	8.29 %
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	4	3	1.71%	1.31 %
Zyra Ligjore	4	4	1.71%	1.74%
Zyra e për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse	-	27	-	11.79 %

Tabela Nr. 2.1

Sqarim:

- Totali i të punësuarve më 01.01.2018 është 233 të punësuar.
- Totali i të punësuarve më 30.09.2018 është 229 të punësuar.

Në muajin shkurt 2018 është bërë ndarja e Departamenti të Operimeve në Departamentin e Transportit të Mallrave, Departamentin e Transportit të Udhëtarëve dhe Zyrën për Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse.

Vërejtje: Në tabelën e paraqitur më lart nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe punëtorët me kontrata specifike.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

III. 1. Gjendja financiare Janar - Shtator 2018

Për periudhën raportuese Janar – Shtator 2018, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III. 2. Të Hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 291,718.58€ për periudhën janar - shtator 2018. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2018, është 720,332.00€ dhe nga kjo del se kemi realizuar 40.50% nga totali. Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 93,269.56€ dhe nga eksporti po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 10,325.06€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për “NewCo Ferronikeli” dhe atë në transportin e xehe nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 188,124.00€.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – shtator 2018, është realizuar në shumën prej 1,348,729.00€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 901,695.97€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 375,000.00€. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 72,033.48€, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 68.61%, krahasuar me planifikimet e vitit 2018 – 1,965,700.00€.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - shtator 2018, kanë arritur shumën prej 14,613.85€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2018, e cila është 50,000.00€ arrin kuotën prej 29.23%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionin të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 14,613.85€.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – shtator 2018, kanë arritur shumën prej 69,087.40€. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siq vijojnë: Të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 32,420.74€, te hyrat nga dëmtimi i vagonëve në vlerë prej 31,741.11€ dhe të ardhurat nga zbritjet e marrura 4,925.55€. Buxheti i planifikuar është 90,000.00€, shprehur në përqindjen 76.76%.

III. 3. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar – shtator 2018, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 630,204.66€ nga 860,000.00€ të planifikuara për vitin 2018 dhe arrijnë kuotën prej 73.28%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – shtator 2018.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,258,850.17€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,255,881.12€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 2,969.05€. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2018 – 1,705,000.00€, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 73.83%.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 97,841.87€, kjo shumë është 10.17% nga shumata prej 962,000.00€ e parashikuar vitin 2018. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – shtator 2018.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 39.24%, konkretisht në shumën prej 38,457.16€. Planifikimi për vitin 2018, i kësaj kategorie është 98,000.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – shtator 2018.


III.4. Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar - Shtator 2018

	EMËRTIMI	Realizimi Janar- Shtator 2018	Buxheti i Rishikuar 2018	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Shtator 2017
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	291,718.58	720,332.00	(428,613.42)	40.50	730,497.68
2	TU – Ministria e Infrastruktues	901,695.97	1,316,000.00	(414,304.03)	68.52	1,151,612.81
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	375,000.00	500,000.00	(125,000.00)	75.00	374,999.94
4	TU – Shitja e Biletave	72,033.48	149,700.00	(77,666.52)	48.12	101,764.97
5	Shërbimet tjera	14,613.85	50,000.00	(35,386.15)	29.23	21,642.00
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonave	31,741.11	40,000.00	(8,258.89)	79.35	14,780.49
7	Të hyrat tjera jo operative	32,420.74	50,000.00	(17,579.26)	64.84	35,521.08
I	TOTAL – TË HYRAT	1,719,223.73	2,826,032.00	(1,106,808.27)	60.84	2,430,818.97
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	295,958.91	360,000.00	(64,041.09)	82.21	475,036.48
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera	6,628.58	30,000.00	(23,371.42)	22.10	33,294.96


	komunale					
3	Inventar dhe pajisje	-	10,000.00	(10,000.00)	0.00	877.17
4	Material harxhues	198.69	1,000.00	(801.31)	19.87	0.00
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	14,688.70	35,000.00	(20,311.30)	41.97	24,843.75
6	Qasja në binarë	263,280.83	330,000.00	(66,719.17)	79.78	426,561.38
7	Sigurimi i palëve të treta	1,977.97	4,000.00	(2,022.03)	49.45	1,627.59
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	11,289.69	40,000.00	(28,710.31)	28.22	26,750.64
9	Shpenzimet e transportit Infrakos	32,512.59	50,000.00	(17,487.41)	65.03	35,698.12
10	Zbritjet e lejuara	3,668.70				602.32
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	630,204.66	860,000.00	(229,795.34)	73.28	1,025,292.41
	Fitimi (humbja) bruto	1,089,019.07	1,966,032.00	(877,012.93)	55.39	1,405,526.56
	TE ARDHURAT TJERA					
1	Te Ardhura të jashtëzakonshme		-	-	0.00	-
2	Zbritjet e mara	4,925.55	-	4,925.55	0.00	11,409.91
3	Te ardhura tjera	-	800,000.00	(800,000.00)	0.00	-
	TOTAL – Te ardhurat tjera	4,925.55	800,000.00	(795,074.45)	0.62	11,409.91
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,255,881.12	1,681,000.00	(425,118.88)	74.71	1,266,718.47
2	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	2,969.05	24,000.00	(21,030.95)	12.37	10,722.55
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,258,850.17	1,705,000.00	(446,149.83)	73.83	1,277,441.02
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	4,736.99	805,000.00	(800,263.01)	0.59	2,418.81
2	Sigurimi fizik – total	30,809.59	52,000.00	(21,190.41)	59.25	28,684.52
3	Shërbimet tjera	-	-	-	0.00	50.00
4	Shpenzimet logjistike	9,631.62	10,000.00	(368.38)	96.32	11,648.21
5	Energjia elektrike dhe komunalite	3,563.13	20,000.00	(16,436.87)	17.82	-
6	Sigurimi i palëve të treta	1,860.07	4,000.00	(2,139.93)	46.50	3,136.99
7	Marketingu	1,599.32	18,000.00	(16,400.68)	8.89	2,448.33
8	Udhëtimet zyrtare	183.00	2,000.00	(1,817.00)	9.15	2,244.40
9	Telefonat dhe Posta	16,626.68	20,000.00	(3,373.32)	83.13	17,184.26
10	Shërbimet bankare	686.45	1,000.00	(313.55)	68.65	785.79
11	Tatimet	26,246.05	20,000.00	6,246.05	131.23	4,499.64
12	Pajisje elektronike	1,898.97	10,000.00	(8,101.03)	18.99	3,157.47
	TOTAL - Shpenzimet operative	97,841.87	962,000.00	(864,158.13)	10.17	76,258.42
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje		-	-	0.00	760.00
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	5,168.65	11,000.00	(5,831.35)	46.99	847.46
3	Material i zyrës	4,938.02	10,000.00	(5,061.98)	49.38	4,183.68
4	Material sanitar	1,317.95	6,000.00	(4,682.05)	21.97	1,968.02
5	Qiraja për objektet	6,850.23	10,000.00	(3,149.77)	68.50	5,915.20
6	Reprezentacioni dhe bufeja	2,607.82	4,000.00	(1,392.18)	65.20	3,055.83
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	14,490.78	22,000.00	(7,509.22)	65.87	13,549.80
8	Shpenzimet logjistike	2,822.86	25,000.00	(22,177.14)	11.29	1,516.06
9	Kontigjente	260.85	10,000.00	(9,739.15)	2.61	5,312.48
	TOTAL - shpenzimet administrative	38,457.16	98,000.00	(59,542.84)	39.24	37,108.53
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	2,025,353.86	3,625,000.00	(1,599,646.14)	55.87	2,416,100.38
III	Fitimi (Humbja) para zhvlersimit	(301,204.58)	1,032.00	(302,236.58)	-29186.49	26,128.50
	GRANTET	747,768.08	986,695.78	(238,927.70)	75.79	667,516.36
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	747,768.08	986,695.78	(238,927.70)	75.79	667,516.36
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	18,714.00	24,588.12	(5,874.12)	76.11	18,132.93
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	766,482.08	1,011,283.90	(244,801.82)	75.79	685,649.29
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	(319,918.58)	(23,556.12)	(296,362.46)	1358.11	7,995.57

Tabela Nr. 3.1

Diagrami 3.1. Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Janar – Shtator 2018



Diagrami 3.2. Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Janar – Shtator 2018



III. 5. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (30.09.2018)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 30-09-2018
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	7,272.65
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	24,988.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	53,983.72
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	0.00
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	0.00
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	0.00
7	BPB	31,542.46
	Totali	117,786.83

Tabela Nr. 3.2

III. 6. Transaksionet e realizuara (janar – shtator) 2018

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2018	10,106.77
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – shtator 2018	729,718.95
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – shtator 2018	732,553.07
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.09.2018	7,272.65

Tabela Nr. 3.3

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2018	442,211.16
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – shtator 2018	187,410.42
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – shtator 2018	575,637.86
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.09.2018	53,983.72

Tabela Nr. 3.4

IV. PASQYRA E PËRFORMANCËS OPERATIVE NË TRANSPORTIN E UDHËTARËVE

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën gjatë periudhës Janar - Shtator 2018, duke krahasuar atë me realizimin e nëntë mujorit të vitit 2017.

Pasqyra e realizimit të transportit të udhëtarëve:

- Biletat e shitura:87,218
- Numri i udhëtarëve:.....86,914

Më poshtë paraqesim tabelën nr. 4.1 ku kemi krahasimin e të dhënave të realizuara gjatë kësaj periudhe me të dhënat e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar:

	Realizimi në Vitin 2017	Realizimi në Vitin 2018	Ndryshimi në %
Numri i udhëtarëve	131.761	86.914	-51.60 %
Të hyrat nga biletat pa TVSH	101,297.18€	70,782.63€	-43.11 %

Tabela Nr. 4.1

IV. 1. Organizimi dhe realizimi i transportit të udhëtarëve

Në tabelën nr. 4.2 janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar – Shtator 2018 me periudhën e njëjtë të vitit 2017, rezulton se kemi një ulje të numrit të udhëtarëve në këtë vit.

Përshkrimi - Udhëtarë	Janar – Qershor
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2017	131,787
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2018	86,914
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2018	122,500
Dallimi: Realizim 2018 - 2017	-44,873
Dallimi: Realizim - planifikimi 2018	-35,586
Dallimi në %: 2018 - 2017	-34.05
Dallimi në %: Realizim - Planifikimi 2018	-29.05

Tabela Nr. 4.2

IV. 2. Numri i trenave, tren kilometër (T/km) dhe udhëtarë kilometër (U/km)

- Numri i trenave të udhëtarëve për gjashtë mujorë gjithsej kanë qenë **1682**.
- Të gjithë trenat e udhëtarëve për gjashtë mujorë kanë bërë **126,032** tren/km.

- Për gjashtë mujorin e parë kanë qenë 5,041,280 udhëtarë/kilometër.

IV. 3. Vonesat e trenave të udhëtarëve

Prej 1682 trena sa kanë operuar në këtë periudhë raportuese, vetëm 18 trena prej tyre kanë shkaktuar këto vonesa siç shihen më poshtë:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje
Lokomotiva HM	205	22.88
Vazhdimi i udhëtimit	132	14.73
Kryqëzimet	0	0.00
Lokomotiva / GM defekt	187	20.87
Lidhja me trenin	0	0.00
Bashkëngjitja e vagonëve. Tërheqja e mjeteve	0	0.00
Doganë + Polici	0	0.00
Pret në garniturë	0	0.00
Aksidente	66	7.37
Të tjera	306	34.15
Total vonesat	896	100

Tabela Nr. 4.3

Gjatë këtij nëntë mujori nuk kanë operuar një numër i konsiderueshëm i trenave 4201/4200/761/760 të relacionit Prishtinë – Pejë – Prishtinë si dhe trenat 4101/4103/4100/4102 të relacionit Prishtinë – Han i Elezit – Prishtinë.

Për një kohë të gjatë kanë qenë në operim vetëm trenat 891/892 për relacionin/linjën ndërkombëtare Prishtinë-Shkup dhe trenat 760/761 në linjën vendore Prishtinë-Pejë ose gjithsej katër trena nga dhjetë (10) të planifikuar.

Ndërsa nga 18.04.2018 sipas marrëveshjes për OSHP-2018 janë futë në qarkullim plus dy trena në linjën Prishtinë-Pejë që gjithsej nga kjo date kemi gjashtë (6) trena dhe ka qenë e pamundur që të arrihet planifikimi i trenave sipas planit të biznesit, pasi që planifikimi për 2018 ka qenë me 10 trena në ditë në të dy relacionet, atë të Hanit të Elezit dhe të Pejës.

Kjo ka ndikuar që të kemi një numër me të vogël të udhëtarëve të cilët kanë përdorë shërbimet tona apo kanë udhëtuar me linjat e sipërpërmendura, rrjedhimisht me rënien e numrit të udhëtarëve kanë rënë edhe të hyrat.

Rikthimi i linjave të sipërpërmendura ka filluar të rikuperojë numrin e udhëtarëve si dhe të të hyrave të planifikuara veçanërisht pas futjes në qarkullim të trenave sipas marrëveshjes së OSHP 2018-2022.

V. PASQYRA E PËRFORMANCËS OPERATIVE NË TRANSPORTIN E MALLRAVE

Departamenti i Transportit të Mallrave, i cili luan rolin kryesor për ne, gjatë periudhës nëntë mujore respektivisht nga 1 janar 2018 deri më 30 shtator 2018 janë arritur këto rezultate:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Shtator
Realizimi Neto Ton në 2017	375,177.55 ton
Realizimi Neto Ton në 2018	137,036.71 ton
Planifikimi Neto Ton në 2018	200,400.00 ton
Dallimi: Realizim 2018 – Realizim 2017	-238,140.84 ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2018	- 63,363.29 ton
Dallimi: Realizim 2018 – Realizim 2017 (%)	36.52 %
Dallimi: Realizim 2018 – Planifikim 2018 (%)	68.38 %

Tabela 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 4.4 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 63.48 % më pakë se sa në të njëjtën periudhë raportuese për vitin e kaluar, ndersa për periudhën janar – shtator 2018 është realizuar 68.38 % e planifikimit.

Transporti i mallrave me kontejnerë është i pasqyruar në tabelën 5.2

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontejnerëve	Janar – Shtator 2018
Kontejnerë të plotë – 2018	0 copë
Kontejnerë të zbrazët – 2018	0 copë

Tabela 5.2

Sasia e transportuar në Neto ton për periudhën Janar-Shtator 2018




Figura 5.1

Gjatë periudhës nëntë mujore, siç mund të shihet nga figura 4.1, në aspektin operativ kemi realizuar 68.38 % të planifikimit.

V. 1. Shfrytëzimi i Trenave

Me njoftimin nga HM dhe klientët është bërë organizimi dhe planifikimi me kohë për arritjen e dërgesave që nga stacioni kufitar deri në stacionin e shkarkimit edhe transporti vendor është realizuar sipas planifikimit.

Import:	49 trena nga 273 të paraparë, ose 17.94 % trena të shfrytëzuar;
Eksport:	46 trena nga 273 të paraparë, ose 16.84 % trena të shfrytëzuar dhe
Vendor:	199 trena nga 546 të paraparë, ose 36.44 % trena të shfrytëzuar
Totali:	294 trena nga 1092 të paraparë, 26.92 % trena të shfrytëzuar

V. 2. Neto Ton & Neto Ton Kilometër të Transportuar

Nga importi janë realizuar 21,003.67 neto tonë nga 42,084 sa kanë qenë të planifikuara, apo është realizuar 49.90 % e planifikimit. Neto tonë kilometër janë 1,630,721 t/km.

Nga eksporti janë realizuar 2,093.99 neto tonë nga 18,036 sa kanë qenë të planifikuara, apo është realizuar 11.61 % e planifikimit. Neto tonë kilometër janë 119,991 t/km.

Nga transporti vendor janë realizuar 113,939.05 neto tonë nga 140,280 sa kanë qenë të planifikuara, apo është realizuar 81.22 % e planifikimit. Neto tonë kilometër janë 2,994,030 t/km.

Në total janë realizuar 137,036.71 neto tonë nga 200,400 sa kanë qenë të planifikuara, apo është realizuar 68.38 % e planifikimit. Neto tonë kilometër janë 4,744,742 t/km.

V. 3. Mallrat e transportuara

Kemi transportuar mallra të ndryshme dhe nga 100.00 % i mallrave të transportuara kemi: Xehe e nikelit 92 %, plin 1 %, laminat 5 %, mall i përzier 1 %, derivate të naftës 1%:




Figura 5.2

VI. ZYRA E MIRËMBAJTJES SË MJETEVE LËVIZËSE - MML

VI. 1. Sektori i mirëmbajtjes

Për mirëmbajtjen e trenave motorik, lokomotivave transportuese, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve si dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit prej 01.01.2018 deri në 30.09.2018 ne kemi pasur këto rezultate.

Matja e produktivitetit në shfrytëzimin e fuqisë punëtore

Matja e shfrytëzimit të fuqisë punëtore tregon se sa dhe ku shfrytëzohet më tepër fuqia punëtore dhe tregon raportin në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

Shërbimi i mirëmbajtjes së lokomotivave gjatë periudhës janar - shtator ka disponuar me fuqi pune prej 12 817.5 orë ku:

- 4361 orë, janë shfrytëzua për riparim apo 34% e fondit total të orëve
- 1485 orë, janë shfrytëzua për punë ndihmese dhe dytësore apo 12% e fondit total të orëve.
- Produktiviteti i tërë ka qenë 46%.

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar - shtator ka disponua me fuqi pune prej 10 633.5 orë ku:

- 2877 orë, janë shfrytëzua për riparim apo 27 % e fondit total të orëve
- 1358 orë, janë shfrytëzua për punë ndihmese dhe dytësore apo 13% e fondit total të orëve.
- Produktiviteti i tërë ka qenë 40%.

VI. 2. Faturimet për riparimin e vagonëve të huaj për periudhën janar - shtator 2018

Vagonët e NewCo Feronikel:

- **Janar- Shtator 2018 është 15,168.00 €,**
- **Janar- Shtator 2017 është, 13,477.00 €.**

VII. PROJEKTET KAPITALE

Nr	Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontrates	Koment
1	Shërbimet e sigurimit fizik te objekteve te Trainkos Sha TRA/17/068/221	Janar	45,000.00	46,444.80 €	Përfunduar
2	Furnizim me nafte per nevojat e Trainkos Sha TRKOS/18/01/111	Mars	1,400,000.00	1,400,000 €	Në vazhdim
3	Furnizimi me material hixhienik TRKOS/18/03/136	Mars	5,500.00	4,663.80 €	Në vazhdim
4	Furnizim me material administrativ TRA/18/04/136	Mars	5,500.00	5,048.10 €	Në vazhdim
5	Furnizimi dhe montimi i dizel motorit te gjeneratorit 55kw	Mars	4,000.00	3,950.00 €	Përfunduar
6	Renovimi i objektit te tërheqjes se trenave TRA/17/061/521	Tetor 2017	200,000.00	180,414.00 €	Në vazhdim
7	Mbikëqyrja e projektit "Renovimi i objektit te tërheqjes se trenave" TRA/075/236	Tetor 2017	4,000.00	950.00 €	Në vazhdim
8	Sigurimi i palëve te treta	Shkurt	2,000.00	1,650.00 €	Në vazhdim
9	Furnizimi me tonera TRKOS/18/02/136	Shkurt	5,000.00	4,224.50 €	Në vazhdim
10	Riparimi i lokomotivës manovruese	Gusht	20,000.00	16,500.00 €	Përfunduar
11	Riparimi dhe atestimi i vincave te trenit ndihmes	Shtator	16,000.00	15,360.00 €	Përfunduar
12	Shërbimet e sigurimit te automjeteve	Mars	2,000.00	1,607.61	Në vazhdim
13	Furnizimi me rollne per arkat fiskale te llojit DP 05	Qershor	3,000.00	2,238.00 €	Përfunduar
14	Shërbimet e pastrimit të ujrave të zeza	Shtator	1,800.00	1,701.00 €	Në vazhdim
15	Furnizimi dhe montimi i vincave dhe mjeteve tjera	Shtator	110,000.00	121,634.40 €	Përfunduar
16	Shërbim konsulence për matjen e kënaqshmërisë së klientëve – Trainkos Sh.A. TRA/17/36/236	Shtator	2,000.00	1,198.50 €	Në vazhdim
17	Riparimi i tornos për gdhendjen e rrotave te mjeteve lëvizëse TRKOS/18/21/221	Gusht	44,000.00	41,949.50 €	Në vazhdim
18	Furnizimi me pjesë për vetura	Korrik	6,003.00	4,318.00 €	Në vazhdim
19	Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva - TRKOS/18/50/136	Gusht	8,000.00	9,005.76 €	Përfunduar
20	Furnizimi me kontenjer të plumbit për izolim të burimit radioaktiv	Shtator	1,000.00	987.65 €	Në vazhdim
21	Furnizimi me pjesë për lokomotivën 2710 009 TRKOS/18/59/136	Shtator	2,550.00	2,444.44 €	Në vazhdim

Tabela Nr. 7.1

VIII. KONTESTET GJYQËSORE

Gjatë periudhës janar - shtator 2018 Zyra Ligjore e HK - Trainkos - Sh.A. ka mbajtur njëzet (20) seanca gjyqësore nga të gjitha kategoritë e kontesteve. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate të mira në zgjidhjen e disa kontesteve në favor të HK - Trainkos - Sh.A. si vijon:

KONTESTET PËR KOMPENSIM DËMI

Nga kontestet e kompensimit të dëmeve gjatë periudhës janar-shtator 2018 kemi mbajtur gjashtëmbëdhjetë (16) seanca gjyqësore, ndërsa në procedurë gjyqësore kemi pasur gjashtë (6) konteste.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:
1.	IV.C.nr.381/15	16,703.00 €	Paditëse
2.	C.nr.1145/15	166,500.00 €	E paditur
3.	C.nr.1111/13	4,500.00 €	E paditur
4.	III.EK.nr.155/16	10,742.00 €	Paditëse
5.	C.nr.155/14	4,000.00 €	E paditur
6.	I.EK.nr.535/14	19,512.00 €	Paditëse

Gjatë këtij nëntëmujori nga Gjykatat, për kontestet e kompensimit të dëmeve kemi pranuar katër (4) aktgjykime të formës së prerë, pjesërisht në favor të paditësve, një (1) aktgjykim të shkallës së parë në favor të Ndërmarrjes si dhe një (1) aktgjykim nga Gjykata Supreme e Kosovës.

AKTGJYKIM

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	Ac.nr.2356/13	2,930.00 €	E paditur	Është ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës në bazë të aktgjykimit të formës së prerë.
2.	C. nr. 286/09	100.000.00 €	E paditur	Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc në favor të Ndërmarrjes.
3.	Ac.nr.1169/14	1,368 € +808,40 €	E paditur	Është bërë kompensimi në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm.
4.	Rev.nr.192/2018		E paditur	Refuzohet si i pabazuar Revizioni i HK-Trainkos-SH.A. paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2356/13 të dt.26.01.2018.

5.	Ac.nr.761/2015	107,757.00€ + shpenzime 5,390.00€ dhe rentë mujore 52.50 €	E paditur	Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës pjesërisht në favor të Ndërmarrjes.
6.	Ac.nr.1730/2014	15,881.00€ + shpenzime 598.30 € si dhe kamatën ligjore	E paditur	Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës pjesërisht në favor të Ndërmarrjes.

KONTESTET PËR PAGIM BORXHI

Nga kontestet për pagim të borxhit gjatë periudhës janar - shtator 2018, HK - Trainkos - Sh.A. ka pranuar dy aktgjykime dhe dy aktvendime.

AKTGJYKIM

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	I.EK.nr.221/15	55,500.00 €	Paditëse	Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Ekonomik në favor të Ndërmarrjes. Lënda në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
2.	Ac.nr.99/2016	6,679.93 €	E paditur	Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë në disfavor të Ndërmarrjes. Është përmbushur detyrimi në vlerë prej 8,492.42 €. Pala paditëse ka ushtruar Revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës. Është ushtuar përgjigje në Revizionin e paditësit.

AKTVENDIM

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës::	Veprimet e ndërmarra
1.	PPP.nr.685/17	2,342.00 €	Debitor	Është ushtruar ankesë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, është bërë pagesa e garancionit në vlerë 2,342.00 €.
2.	P.nr.976/17	224,318.20 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
3	Rev.nr.8/2018	6,679.93 €	Debitor	Lënda e përfunduar

KONTESTET E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Nga kontestet e marrëdhënies së punës gjatë periudhës janar – shtator 2018 kemi mbajtur katër (4) seanca gjyqësore, ndërsa në procedurë gjyqësore kemi pasur tri (3) konteste.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:
1.	C.nr.607/14		E paditur
2.	C.nr.291/17	41,500.00 €	E paditur
3.	C.nr.1069/17	49,895.12 €	E paditur

Sa i përket kontesteve të punës në këtë nëntëmuor kemi pranuar katër (4) aktgjykime dhe një (1) aktvendim.

AKTGJYKIM

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	C. nr. 1069/17	49,895.12 €	E paditur	Është aprovuar kërkesëpadi e paditësit. Pritet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës së të paditurës
2.	C.nr.291/17	41,500.00 €	E paditur	Është refuzuar kërkesëpadi e paditësit. Pritet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës së paditësit
3.	C.nr.607/14		E paditur	E përfunduar në favor të Ndërmarrjes në shkallë të parë.
4.	Rev.nr.272/2017	270.00 €	E paditur	E përfunduar në favor të Ndërmarrjes.

AKTVENDIM

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	Rev.nr.234/17		E paditur	Lëndë e përfunduar në favor të Ndërmarrjes.

KONTESTET GJATË VITIT 2018

Gjatë kësaj periudhe kemi pranuar dy (2) padi të reja si vijon:

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	C.nr.254/18	Pagat jubilarë	E paditur	Është përgatitur përgjigje në padi.
2.	C.nr.1512/18	Kontest pune	E paditur	Është përgatitur përgjigje në padi.

LËNDËT PËRMBARIMORE

Sa i përket lëndëve në procedurë përmbarimore HK - Trainkos - Sh.A. gjatë periudhës janar-shtator 2018, në procedurë ka pasur shtatë (7) lëndë, ku në gjashtë (6) prej tyre HK - Trainkos - Sh.A. është në cilësinë e debitorit ndërsa vetëm në një (1) lëndë ka cilësinë e kreditorit dhe atë në procedurë të kundërpërmbarimit.

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	PPP.nr.864/2017	125,521.95 €	Debitor	Është ushtruar ankesë, lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, është bërë pagesa e garancionit në vlerë 125,522.00 €.
2.	P.nr.173/2017	827,259.27 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
3.	P.nr.976/2017	224,318.20 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
4.	P.nr.111/2018	4,705.82 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
5.	Rev.272/2017	270.00 €	Kreditor	Është ushtruar propozim për kundër përmbarim në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
6.	P.nr.2360/18	312.00 €	Debitor	
7.	P.nr.294/2018	857.70 €	Debitor	Është ushtruar prapësim, lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

AKTVENDIM

Nr.	Nr. lëndës	Vlera €	Trainkos Sh. A në cilësinë e palës:	Veprimet e ndërmarra
1.	PPP.nr.684/17	3,852.00 €	Debitor	Është refuzuar prapësimi i ushtruar nga Ndërmarrja, lënda gjendet në shkallë të dytë sipas ankesës.
2.	Ac.nr.1115/2018	125,521.95 €	Debitor	Është refuzuar si e pa bazuar ankesa e ushtruar nga Ndërmarrja.
3.	PPP.nr.864/2017	52,773.45 €	Debitor	Është urdhëruar shërbimi financiar i gjykatës që shuma e deponuar e mjeteve për garancion 52,773.45 €, të bartet në llogari të Përmbaruesit Privat.

Prej lëndëve përmbarimore duhet cekur faktin se për momentin ekziston rreziku i përmbarimit-ekzekutimit të lëndëve përmbarimore ndaj Kreditorit Infrakos SH.A. në vlerën prej **827,259.27 €**, e cilat gjendet në procedurë në Gjykatën Themelore në Prishtinë sipas prapësimit, përkatësisht ankesës të ushtruar nga debitori HK-Trainkos - Sh.A.

IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

Departamenti për Zhvillim e Biznesit në periudhën Janar – Shtator 2018 ka zhvilluar aktivitete sipas obligimeve që rrjedhin nga përshkrimi i vendeve të punës për këtë Departament, Planit të Biznesit për vitin 2018 dhe Planit të Punës. Po ashtu gjatë periudhës raportuese janë kryer edhe detyra tjera që dalin sipas nevojës dhe kërkesave të Menaxhmentit. Aktivitetet më të rëndësishme për periudhën Janar - Shtator janë të specifikuar më poshtë:

1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit;
2. Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera;
3. Aktivitet e Marketingut;
4. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore;

IX. 1. Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Gjatë periudhës raportuese kemi realizuar aktivitete të shumta për të siguruar mbështetje në hartimin e një Plani Biznesi afatmesëm (3 apo 5 vjeçar) tek IFN-të (Institucionet Financiare Ndërkombëtare) dhe mistria/ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Kontaktet e vazhdueshme me BERZh-in (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) kanë rezultuar me konkretizim të kërkesës sonë për mbështetjen financiare të një Asistence Teknike që TRAINKOS-it do të i mundësonte përgatitjen e Plani të Biznesit paralel me zhvillimet tjera në sektor.

Angazhimi jonë gjatë këtij nëntë mujor është mbështetur në planifikimet strategjike që ka shteti i Kosovës dhe zbërthimi i këtyre strategjive në plane të veprimit. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është që me shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë IFN-të dhe Bashkësia Evropiane (BE) me mekanizmat e sajë të bëhet fillimisht investimi në Linjat ekzistuese hekurudhore, pastaj të vazhdohet me Linjat tjera të reja të identifikuar me “Strategjinë Sektoriale dhe Transportin Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar”.. Mbështetja konkrete e BE dhe mekanizmave që ka krijuar BE-ja ka ndodhur në proceset e përgatitjes dhe investimit në projektin “Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore” Hani i Elezit – Leshak

Veprimet e domosdoshme afatshkurta për zhvillimin e sektorit hekurudhorë janë dhe kërkesa të BE-së për zbatim të përfshira në strategjinë e përgatitur për shtetet e Evropës Jug – Lindore. Kushtet të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e transportit hekurudhorë janë: Ratifikimi i Traktatit për Transport, finalizimi i marrëveshjes ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë dhe sigurimi i mjeteve financiare të domosdoshme për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore. Për sektorin hekurudhorë do të avancohet baza legjislative sipas nevojave gjatë proceseve, për operatorin

shtetërorë të sigurohen në kohë të përshtatshme mjete financiare përmes IFN-ve për blerjen e mjeteve lëvizëse adekuate me modernizim e Linjave hekurudhore, sigurohen punëtoritë adekuate për servisim dhe riparim të mjeteve lëvizëse dhe angazhimi për anëtarësim në asociacionet hekurudhore Evropiane.

Në vazhden e mbështetjes së sektorit hekurudhorë nga BE-ja përmes mekanizmave të krijuar dhe raporteve të SEETO-s për Evropën Jug – Lindore ka filluar projekti përmes CONNECTA-s në shtator 2017, në periudhën raportuese janë mbajtur katër takime që kanë rezultuar me përgatitjen dhe aprovimin në nivele teknike por edhe me prezantim final para TRAINKOS-it, INFRAKOS-it, ARH-së dhe MI-së, e që ka të bëjë me formulën më të mirë dhe propozimet optimale (skenarë të ndryshëm optimist) për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave. Ky projekt i rëndësishëm që ka zgjatë një vit e gjysmë duhet të zbatohet menjëherë nëse e kemi parasysh kohën e nevojshme që planifikimet të inkorporohen në planet afatmesme dhe afatgjata për Kosovën si shtet i Ballkanit Perëndimorë si dhe secilit shtet nga kjo pjesë e Evropës veç e veç.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për Neë Co Ferronikeli nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas ka stagnuar nëse e kemi parasysh problemet me të cilat është ballafaquar kjo kompani dhe moszbatimi i transportit sipas kontratës për vitin 2018, mirëpo e gjitha kjo ka përfunduar në fillim të kvartalit të tretë dhe përkundër vështirësive ka rezultuar me ndërrimin e pronarit dhe në nënshkrimin e kontratës së re shpresëdhënëse për transportin vendor dhe ndërkombëtar të mallrave.

Kontaktet e rregullta me partnerët regjional, kryesisht me ata të Republikës së Maqedonisë janë të përqendruara në krijimin e mundësive për të rritur transportin. Periudha raportuese përfshinë edhe angazhimin e vazhdueshëm për të diskutuar dhe përfutur nga ofrimi i mundësive për transportin e lëndës finale - Cement, Transportin e xehes që vjen nga Kukësi (Shqipëri) në drejtim të Kavadarci (Maqedoni), transportin e kontejnerëve nga Porti Pireus (afër Athinës, Greqi), transporti i derivateve të naftës nga OKTA, transporti i xeheve dhe mineraleve potencial nga proceset e dhënës së licencave nga AKP-ja, etj.

Problemet e transportit me hekurudhë deri në Portin e Selanikut vazhdojnë, klientët potencial kanë gjetur zgjidhje në forma tjera të transportit dhe kthimi i tyre është sfidë në vete dhe kërkon angazhim plotësues për të i kthyer mbrapa transportin nga ky Port, kryesisht kur destinacioni final është në territorin e Kosovës. Për një kthesë pozitive nevojitet edhe angazhimi i Aksionarit – MZHE-së dhe subjekteve tjera brenda Qeverisë që merren me politika dhe financim të sektorit hekurudhorë.

Periudha raportuese ka rezultuar me finalizimin e procesit të përgatitjes për nënshkrim të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 dhe fillimit të zbatimit të sajë. Vonesat në këtë proces rezultojnë në problemet organizative dhe financiare që mund dhe po ndeshet TRAINKOS-i. Me fillimin e zbatimit të kësaj Marrëveshje, sidomos pas analizës për periudhën raportuese vërehet

se funksionimi i trenave të aprovuar nuk do të përmbyll vitin 2018 me shumën e buxhetor fillimisht, nëse MI nuk do të sigurojë mjetet për pjesën tjetër të vitit do të përsëritet viti 2017 dhe problemet me likuiditet për TRAINKOS-in

IX. 2. Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera.

Periudha raportuese rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Infrastrukturës (MI), ARH-në, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE); ESK (Enti Statistikor i Kosovës) dhe BERZh.

- Gjatë periudhës raportuese është bërë koordinimi dhe zhvillimin e aktiviteteve në përgatitjen e raportit narrativ për DPSA – kuarteti i parë 2018 që ka rezultuar me takimin e Brukselit, raport që përmban kritika të rrepta në zbatimin e Ligjit për Hekurudha, sidomos në mosfunksionimin e Marrëveshjes së OShP-së dhe problemet me shkurtrimin e linjave të transportit të udhëtarëve;
- ARH, konkretisht Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, ka kërkuar dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me Ministrinë e Infrastrukturës;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;
- Gjatë periudhës raportuese jemi pajisur me Certifikatën e Sigurisë (A dhe B) për periudhën 5 vjeçare 2018-2022.
- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese;
- Është finalizuar dokumenti “Manualit për makinistët” i cili është dërguar për procedim të mëtutjeshëm;
- Përmes SEETO-s për procesin e monitorimit të Raportit të Progresit janë plotësuar kërkesat sipas pyetësorëve të kërkuar dhe në këtë periudhë kemi rishikuar avancimet në procesin e “masave të buta” për vitin 2018 që janë bazë për zbatim dhe kërkesa për zhvillim dhe avancim. Ngecjet në zbatimin e Marrëveshjes së OShP-së janë brengë e cila është e ngritur me faktorin ndërkombëtarë, posaçërisht me Bashkësinë Evropiane përmes mekanizmave të krijuar për këtë qëllim;
- Kërkesa e zyrtarëve nga ESK (Enti i Statistikave të Kosovës) për plotësimin e pyetësorit sipas kërkesave të EUROSTAT-it është plotësuar nga ana e TRAINKOS-it

IX. 3. Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH.A. edhe gjatë këtij nëntëmujori ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkesë që kanë në drejtim të kompanisë.

Në kuadër të vizitave drejtim klientëve potencial është përgatitur një listë klientët kryesor potencial, listë e cila është aprovuar nga menaxhmenti i kompanisë, dhe bazuar në këtë janë realizuar vizita të drejtpërdrejta për shqyrtimin e mundësisë për realizimin e transportit me Hekurudhë, tek shumë kompani në Kosovë të cilat importojnë dhe eksportojnë mallra të ndryshme në dhe nga Kosova.

Po ashtu gjatë këtij nëntëmujori nuk kanë munguar edhe aktivitet në rrjetet sociale, duke prezantuar shërbimet tona në transportin e mallrave dhe në transportin e udhëtarëve.

IX. 4. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore

Raportimet e rregullta në CIT (International Rail Transport Committee) vazhdojnë të bëhen. Edhe në vitin 2018 aktivitetet në gjetjen e modalitete për të u anëtarësuar në asociacionet hekurudhore ndërkombëtare vazhdojnë të ndodhin . Vlen të përmendet se kjo ende po varet nga politikat shtetërore të cilat po zhvillohen dhe gatishmëria e institucioneve relevante qeveritare për të vepruar në këtë drejtim. Kjo temë dhe shume çështje tjera që kanë të bëjnë me TRAINKOS-in janë diskutuar edhe me Drejtorin e CER-it (Komuniteti Hekurudhorë Evropian) në takim vjetorë të mbajtur në Prishtinë, ku fokus të veçantë ju është dhënë planifikimeve dhe projektet strategjike të BE-së për shtete e Evropës Jug – Lindore (Ballkani Perëndimorë).

Duke pasur parasysh që Kosova ende nuk është e anëtarësuar në asociacione të ndryshme ndërkombëtare, kjo ka bërë që mos të kemi raportime tjera pasi që nuk pranojmë kërkesa apo obligime ligjore për një gjë të tillë.

X. SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUdhËS JANAR – SHtATOR 2018 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2018 si edhe viteve tjera kompania ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida si në vijim:

Mos respektimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës Nr. 04 / L-076 për mbulimin e shpenzimeve për OSHP, nënshkrimi i Marrëveshjes për OSHP 2018 – 2022 më 18.04.2018 kufizon linjat në minimum dhe sipas planifikimeve në KASH 2018 – 2021 nuk parashihet ndonjë zhvillim / reformë në këtë lloj të transportit publik;

1. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
2. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
3. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
4. Vonesat në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore” si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhorë);
5. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
6. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
7. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
8. Mungesa e një “Master Plani afatmesëm” për TRAINKOS-in;
9. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkuorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
10. Mos funksionimi normal (sipas planifikimeve) i klientit kryesorë në transportin e mallrave
11. Moshja mesatare e lartë e personelit ekzekutiv;

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t’i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.

Edhe në vazhdim ne mbetemi të përkushtuar dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në arritjen e realizimit të objektivave.



**Fushë Kosovë,
Tetor 2018**